

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

STUDIM

Plehrimi i kombinuar me ujitje në kulturën e dardhës

Vendi i zbatimit Shamogjin

Pemëtaria si prioritet i zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë po zhvillohet me ritme të shpejta në të gjitha degët dhe strukturat e saj.

Bima nëpërmjet sistemit rrënjor tërheq nga toka çdo vit sasi të konsiderueshme lënde organike në trajten e kriprave të N, P, K, Fe, Cu, Mg, Br, Mb, etj. Janë këta element të depozituar në % të ndryshme në tokë që mundësojnë rritjen, zhvillimin dhe prodhimtarinë e bimëve bujqësore të kultivueshme.

Në periudha të caktuara të aktivitetit jetësor të kulturave drufrutore kërkesa për elementet ushqyese janë të ndryshme.

Në periudhën e futjes së pemëtores në aktivitetin e prodhimit kërkesat për lëndët ushqyese rriten në krahasim me periudhën e rritjes. Në rast se në këtë periudhë do të kemi mangësi, bima do të reflektojë tek prodhimi në drejtim të sasisë dhe cilësisë.

Për të shmangur këto anomali dhe për të rregulluar bilancin e lëndëve ushqyese në tokë çdo vit ndërhyet me anë të plehrimit ku shpesh herë është i shoqëruar me ujitje.

Vitet e fundit me imputet e ardhura për zhvillimin e bujqësisë në zërin e plehrave kimik janë futur dhe shumë plehra të tipit kristalin më përmbajtje të mikroelementëve që jepen në trajtë solucioni nga gjethet dhe rrënjët në periudha të veçanta të aktivitetit vegetativ që ndikojnë në rritjen e prodhimit.

Në fazën e parë pemët frutore karakterizohen nga një rritje e fuqishme vegetative. Ato kanë nevojë për azot në kushtet e sigurimit të plotë të fosforit, potasit dhe kalciumit (formojnë skeletin, kurorën dhe kushtet për të hyrë në prodhim). Teprimi me plehrim azotik rezikon vonesën e hyrjes në prodhim, sidomos tek farorët.

Në fazën e dytë që karakterizohet nga rritja vegetative dhe fillimi i hyrjes në prodhim kërkesat për azot vazhdojnë të kenë prioritet, krahasimisht me elementet e tjera, por janë më të ulta se në fazën e parë të frutifikimit.

Në fazën e tretë që përkon me hyrjen në prodhim dhe prodhimin e plotë kërkesat për lëndë ushqyese janë të ekuilibruara dhe më të larta se në fazat e tjera. Raporti i elementeve ushqyese N, P, K është afërsisht 1:0.3:0.2. Ky raport ndryshon në varësi të kulturave.

Në fazën e katërt të rënies së prodhimit dhe të tharjes rëndësi merr azoti për përtëritjen e bimës.

1. Objektivi i studimit

Përcaktimi i kohës më të përshtatshme të kombinimit të plehrit në kulturën e dardhës.

Studimi u krye në disa prova

Prova 1: Dëshmues (pa plehrim duke shfrytëzuar sasinë e elementeve në tokë).

Prova 2: Ujitje pas lulëzimit gjatë rritjes së frutit e shoqëruar me (Rosasol 20;20;20)

Prova 3: Ujitje e kombinuar me plehrim në periudhën e rritjes intensive të frutave (Rosasol 20;20;20).

Për studim u morën 10 bimë për çdo provë.

2. Treguesit e marë në studim:

Treguesit e bimës

- Rritja e Kurorës
- Rritja e diametrit të trungut

Të dhëna për frutin

- Pesha e frutit
- **Analiza kimike e frutit**
 - % e aciditeti
 - % e sheqerit


3. Rezultate dhe diskutime:

Të dhënat e marra dhe të përpunuara për vëllimin e kurorës.

Për matjen e vëllimit të kurorës të dhënat u morën në muajin Mars pas krasitjes dhe kur bima sapo ka filluar aktivitetin e saj, dhe matjet e dyta u morën në muajin Nëntor kur bima është futur në qetësinë dimërore dhe rritja vjetore ka përfunduar. U kryen matjet për lartësinë e bimës në të dy muajt Mars dhe Dhjetor.

Për matjen e Vëllimit të kurorës u përdor formula:

$$VC = \frac{2}{3}\pi D^2/4.H$$




Grafiku 1. Paraqitja grafike e rritjes së vëllimit të kurorës sipas provave.

Rritja e sipërfaqes së trungut

Matjet për llogaritjen e sipërfaqes së trungut u kryen në dy periudha, në muajin Mars dhe Nëntor. Llogaritja e sipërfaqes së rritjes së trungut u bë me formulën:

$$ST = 3.14(P/2\pi)^2$$




Grafiku 2. Paraqitja grafike e rritjes së sipërfaqes së trungut

3. Analizat kimike të frutit

Tabela 1. Analizat e frutit

Nr.	% e sheqerit Mesatare për 10 bimë	Pesha e frutit (gr) Mesatare për 10 bimë
Prova 1	11.9	164
Prova 2	13.1	175
Prova 3	14.2	210



Grafiku 3. Paraqitja grafike e rritjes së frutit

Konkluzione

Zhvillimi i bimës në një cikël dallohet nga dy elemente të rëndësishëm që janë: rritja e volumit të kurorës dhe rritja e vëllimit të trungut. Këta dy elementë përcaktojnë rritjen vjetore të bimës.

Në studimin e realizuar në bazën e Shamogjinit në kulturën e dardhës u ndoqën tre prova për të përcaktuar fazën e zhvillimit të frutit më të mirë për ujitje të shoqëruar me plehrim.

1. Nga të dhënat e mara del se: volumi i kurorës është më i madh në provën ku ujitja është shoqëruar me plehrim në fazën e rritjes intensive të kokrrës.
2. Rritja e sipërfaqes së trungut është më e madhe në provën ku ujitja është e shoqëruar me plehrim (Rosassol 20;20;20) në fazën e zhvillimit intensiv te frutit.
3. Pesha e frutit është më e madhe në provën e tretë (ujitja është shoqëruar me plehrim Rosassol 20;20;20).

Si përfundim del se: Koha më e përshtatshme ku ujitja të shoqërohet dhe me plehrim është ajo e rritjes intensive të frutit.

Përhapja (propagandimi) i rezultateve.

Rezultatet e arritura nga ky studim do t'u bëhen të njohura të gjithë fermerëve me anë të demonstrimit të rezultateve të këtij studimi si dhe nëpërmjet fletëpalosjes që do bëhet nga specialistët që ndoqën këtë studim.

Literatura

Dow, I.A. 1980. *Critical nutrient ranges in Northwest crops*, WREP 43 (Washington State University, Irrigated Agriculture Research and Extension Center, Prosser, WA, and the Northwest Soil and Plant Test Work Group).

Gardiner, D.T. 1989. *Phosphorus nutrition of pear seedlings with different mycorrhizae and of wheat cultivars with different efficiencies*. Ph.D. Thesis (Oregon State University, Corvallis).

Horneck, D.A., J.M. Hart, K. Topper, and B. Koepsell. 1989. *Methods of soil analysis used in the Soil Testing Laboratory at Oregon State University*, SM 89:4 (Agricultural Experiment Station, Oregon State University, Corvallis).

Lombard, P.B. 1970. Do fat K rates pay on pears? In *Better Crops with Plant Food*, No. 4 (Potash Institute of N. Am., Atlanta).

Raese, J.T. 1989. *Effect of weed control and nitrogen fertilizer rates on growth, yield, fruit quality, and mineral composition of apple and pear trees*. Proceedings 40th Annual Far West Regional

Fertilizer Conference, Coeur d'Alene, ID, July 23-25, 1989. Sanchez, E.E. and T.L. Righetti. 1990. Managing nitrogen in pears. *Good Fruit Grower*, October, 1990 (pp. 12-16).

Sanchez, E.E., T.L. Righetti, D. Sugar and P.B. Lombard. 1990. Seasonal differences, soil texture and uptake of newly absorbed nitrogen in field-grown pear trees. *J. Hort. Sci.* 65(4):395-400.

Sanchez, E.E., T.L. Righetti, D. Sugar and P.B. Lombard. 1990. Response of Comice pear trees to a postharvest urea spray. *J. Hort. Sci.* 65(5):541-546.

Stevens, R.G. and R.B. Tukey (eds.). 1983. *Tree fruit nutrition*. 1983 Shortcourse Proceedings (Washington State University Cooperative

Specialist

Athina Llambro

Lumturi Xhelilaj